

Vështirësi dhe risi në punën e gazetarit të terrenit në raportimin e pandemisë

Intervistë me gazetaren e Top Channel, Anila Hoxha

- **Situata e krijuar pas pandemisë Covid 19 shkaktoi një ndryshim rrënjësor jo vetëm në mënyrën e jetesës së gjithsecilit, por edhe në ritmet e punës dhe mënyrën e raportimit. Si e përjetuat ju këtë ndryshim dhe çfarë elementësh të rinj mund të evidentoni në raportimin gazetaresk në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe, specifikisht në raportimin nga terreni?**

Ditët e para të muajit mars ishin më të vështirat qoftë në aspektin personal, ashtu dhe në kuptimin profesional. Nuk ishte njëllë si të raportojë për ngjarje të fushës që mbuloj në përditshmëri. Duhej të raportoja për lajme ku në një farë mënyre edhe vetë isha lajm, kam parasysh përpjekjet e fillimit për të siguruar mjaftueshëm maska fytyre, doreza, dezinfektantë. Për rrjedhojë, ditë pas dite, duke parë edhe situatat me të cilat ndeshesha vetë, siç ishin luhatja e çmimeve, mungesa e produkteve të lartpërmendura, natyrisht çdo situatë i duhej përshkruar dhe raportuar publikut. Por gjatë këtyre ditëve, u kujdesa që të informoja publikun teksa edhe vetë iu nënshtrova një procesi informimi për pandeminë, për çështje që lidheshin drejtpërdrejt me mënyrën e re të sjelljes, dhe për elementë shumë të thjeshtë si për shembull si mbahet maska. Në një rast kur po raportoja, maska lëvizi dhe ra poshtë hundës dhe gjatë raportimit shtova: kjo mënyrë e mbajtjes së maskës nuk është e duhura. Kuptova se informacioni në rast pandemie duhet të ishte sa më i kuptueshëm, pra t'u tregohej qytetarëve çfarë duhet të bënin, por njëkohësisht si duhet t'i qaseshin kësaj gjendjeje edhe qytetarë që gjendeshin në rrethana të vështira, si për shembull të dënuarit.

- **Si arritët të balanconi ruajtjen e shëndetit personal, të familjes dhe kolegëve nga njëra anë dhe nevojës së reporterit për të qenë sa më pranë “pikave të nxehta” për një raportim sa më të menjëhershëm, sa më të saktë dhe informues për publikun?**

E thashë dhe më sipër, teksa informoja nuk harroja që të qëndroja në informim të vazhdueshëm. Parë me syrin gazetaresk, fare mirë mund të isha dhe unë lajmi. Ditët e para ndonëse isha më e mbërthyer nga paniku, u përpoqa mos ta pasqyroja këtë gjendje emocionale gjatë raportimit të lajmeve. Në redaksinë e TCH ndryshoi formati i organizimit të mbledhjeve. Ne takoheshim në natyrë, jo në zyrë, dhe larg njëri-tjetrit. Vendosëm që grupet të ishin fikse, për të parandaluar përhapjen e infeksionit në rast të prekjës së njërit prej nesh, duke e minimizuar karantinimin vetëm në 3 persona (shoferi, kameramani dhe gazetari) në rast se njëri prej tyre prekej. Gazetarët e terrenit ndërprejnë kthimin në redaksi që mos të ktheheshin në vatra. Pra ndryshuam rutinën e përgatitjes së lajmit. Gjithçka tjetër ishte ndjekje rigorozë e rregullave. Por natyrisht që isha e papërgatitur për të qenë absolutisht e kujdesshme gjatë raportimeve live, kur ndërkohë ishte e domosdoshme marrja e intervistave në aeroportin e Rinasit. Disa herë kam shkelur distancën për shkaqe teknike, por menjëherë sapo përfundonte raportimi i jam nënshtuar dezinfektimit. Në një rast, pasi sigurova një punonjëse në fasoneri në një nga vatrat e

Covid-it në Krujë, u gjenda në një vështirësi. Gjatë transmetimit live, e intervistuar deklaroi se ishte prekur nga Covid-i ndërkohë që intervista po zhvillohej live. Megjithatë ne e vazhduam në distancë intervistën, edhe pse u frikësua, nuk e ndërpreva prononcimin e gruas që denoncoi shkeljen e Kodit të Punës, ndërsa pasi ajo përfundoi i kërkoja moderatores të largoheshim. Edhe pse u dezinfektova, iu nënshtroam si grup xhirimi tamponëve dhe analizës serologjike, ndërsa momenti më i vështirë që erdhi më pas ishte qëndrimi në të njëjtën shtëpi dhe ruajtja e familjarëve në kushte karantine derisa dolën përgjigjet e analizave.

- **Pasur parasysh këtë situatë, cilat ishin marrëdhëniet specifike që krijuat me burimet e informacionit (specialistë të fushës, titullarë të institucioneve përgjegjëse, apo të afërm të personave të prekur nga Covid 19) dhe në ç'mënyrë arritët t'i bëni ekspertizat apo dëshmitë e tyre pjesë të raportimeve tuaja?**

Pandemia ndryshoi krejtësisht mënyrën e “vjeljes” së informacionit si fillim, pastaj edhe të marrjes së intervistave. Intervistat me titullarët i kam realizuar kryesisht përmes skype. Por ndërkohë pandemia solli edhe një formë të re të funksionimit të institucioneve, përfshi gjykatat, burgjet apo edhe policinë. Në këtë pikë duhej raportuar dhe i duhej thënë publikut çfarë shërbimi merrnin në gjyqësor, cilat janë çështjet urgjente që trajtohen, ky informacion në disa raste u sigurua përmes burimeve që treguan se shumë qytetarë të ndaluar për vepra të lehta nuk u dërguan në paraburgim nga frika e përhapjes së Covid-it nëpër burgje. Pjesa më e vështirë ishte raportimi i situatës në burgje, duke pasur parasysh se edhe në ditë normale të raportosh për burgjet është e vështirë nga vetë natyra e sistemit penitenciar për të qenë sa më i mbyllur edhe për publikun. Ndaj aksesimi i burimeve u realizua përmes telefonit, kryesisht whatsapp për të përfutur të dhëna ku u tregua se cila kategori përfitoi leje të posaçme për të qëndruar në shtëpi gjatë pandemisë, por njëkohësisht kam përdorur edhe rrjetin social Facebook pasi qytetarët më kanë vënë në dijeni për dyshimet se familjarë të tyre ishin prekur nga Covid-i, por autoritetet nuk bënin transparencë. Për raste të tilla konfirmimet i kërkoja përmes zyrës së shtypit apo duke telefonuar direkt zyrtarë të burgjeve apo ministrisë së drejtësisë.

- **A mund të hiqni një paralele mes situatës së krijuar pas Covid 19 dhe rasteve të tjera të vërejtura në të shkuarën (gripit i shpendëve, AH1N1)? Çfarë specifikash mund të veçoni për situatën e tanishme, krahasuar me eksperiencat e mëparshme nga raportimi i këtyre epidemive?**

E vetmja ngjashmëri që shikoj lidhet me frikën e qytetarëve. Në rastet e gripit të shpendëve, viti 2005 apo edhe AH1N1 ne raportim, por ato perceptoheshin si ngjarje që po ndodhnin larg vendit tonë. Raportimi u fokusua kryesisht në reagimin e autoriteteve, të cilat mbaj mend që reagon duke bllokuar tonelata me shpendë që po futeshin në Shqipëri, apo dhe me përpjekjet e autoriteteve për të parandaluar infeksionin. Raportimet ishin intensive në këtë kuptim, sikurse edhe në raportimet e lajmeve nga bota që zinin një fashë të mirë kohe. Fillimisht edhe për Covid 19, lajmet në muajin shkurt ishin raportime të lajmeve nga bota, me pas u zgjeruan me raportimet vendase për masat e institucioneve siç ishin deklaratat për spitalet e Covid-it, derisa u konstatua rasti i parë që e ktheu Covid-in në një lajm që nuk trajtohej thjesht përmes statistikave.

- **A i gjykoni si të rëndësishme shtyllat bazë të raportimit dhe aspektet e etikës në profesion edhe në raste të tilla raportimi dhe sa parasysh janë mbajtur në përvojën e raportimit të kësaj periudhe?**

Etika është primare dhe mendoj se mediat e respektuan së bashku me parimet bazë të raportimit. Si fillim gazetarët nuk publikuan të dhënat personale të pacientëve në shumicën e rasteve. Edhe pse në shumë raste u kuptua sikur gazetarët po u kërkonin llogari qytetarëve që kishin shkelur masat kufizuese, mendoj që edhe ky informacion ishte i domosdoshëm për sa kohë vendi u fut në karantinë. Pati raste kur raportimi i gazetarëve mbi gjrobat e vendosura mund të shikohej si zëdhënie e veprimeve të policisë, mendoj gjithashtu që ky informacion ishte i domosdoshëm.

- **Çfarë problematikash do të veçonit për gjendjen dhe funksionimin e medias në përgjithësi në këtë situatë të re, dhe rolin e reporterit si figurë profesionale në gjendjen e re të krijuar? A e gjykoni si të vlerësuar sa duhet këtë rol?**

Mendoj që në disa raste gazetarët u paragjykuan, siç ishte edhe raportimi i herëpashershëm i vendosjes së gjobave, apo edhe i shkeljeve të karantinës. Por gjatë pandemisë, pavarësisht punës së palodhur të gazetarëve mendoj që sërish mungoi gazetaria investigative, për probleme mbi të cilat nuk u hodh dritë dhe nuk u kontrolluan të dhënat zyrtare, si fjala vjen, a u ndihmuan me ushqime shtresat në nevojë, apo si qëndron e vërteta për testimet. Ishte një situatë e re që nxori në pah sërish probleme të vjetra, ku gazetari përsëri, në shumë raste, u pozicionua vetëm te reagimet institucionale, duke e larguar nga problemet që ndeshën gjatë pandemisë qytetarët.